

VENDIM
Nr. 399, datë 1.6.2016

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 55, DATË 27.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PARAQITJES, FORMËS DHE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË GRADAVE, SIMBOLEVE, UNIFORMAVE DHE SHENJAVE TË POLICISË SË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 62, 97 e 98, pika 1, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 55, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas nënndarjes 4.5 shtohet nënndarja 4.6, me këtë përmbajtje:

"i. 4.6. Uniformë civile për zyrtarët e pritjes së qytetarëve në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, sipas modelit në lidhjen nr. 3/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi;"

b) Në paragrafin e fundit, pas referencës "...4.4..." shtohet "... 4.6...;"

2. Në pikën 6, pas nënndarjes 6.9 shtohet nënndarja 6.10, me këtë përmbajtje:

"6.10 periudhën tranzitore të përdorimit të uniformës që është në përdorim dhe të uniformës së re, që do të miratohet."

3. Në albumin bashkëlidhur vendimit bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në lidhjen nr. 1, në faqet 5 e 6, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i) Përmasat "...60 mm x 58 mm..." zëvendësohen me "...60 mm x 52 mm...";

ii) Fjalët "...përzierja; 67% pambuk – 33% fibër poliestër +/- 3%..." zëvendësohen me "...përzierja; 50% lesh – 50% fibër poliestër +/- 3%...";

iii) Fjalët "Pesha e tekstilit 125 g/m² +/- 5 g..." zëvendësohen me "Pesha e tekstilit 220 g/m² +/- 5 g...";

iv) Pas fjalëve "...material plastik..." shtohen "...përveç gradave të mëdha të spaletit ceremonial, të cilat i kanë elementet brenda gradës metalike ngjyrë ari, dhe...";

b) Në lidhjen nr. 3, në faqet 27, 31 dhe 32, shtohet pjesa e uniformës së veçantë, si më poshtë vijon:

i) "Bluzë pambuku me 3 kopsa, me mëngë të gjata, ngjyrë blu", sipas modelit në lidhjen nr. 3/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii) "Këpuçë vere", sipas modelit në lidhjen nr. 3/c, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) Në lidhjen nr. 3, në faqen 42, shtohet si pjesë e uniformës ceremoniale:

"Kostumi ceremonial", për trupën ceremoniale, sipas modelit në lidhjen nr. 3/d, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ç) Në lidhjen nr. 4, në faqen 47, fjalët "Në pjesën e poshtme...", zëvendësohen me "Në pjesën e sipërme...".

II. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i shtetit për vitin 2016, për programin buxhetor "Policia e Shtetit".

III. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

UNIFORMA PËR ZYRAT E PRITJES SË QYTETARËVE



Lidhja nr.3/b

BLUZË PAMBUKU ME 3 KOPSA ME MËNGË TË GJATA, NGJYRË BLU



Lidhja nr.3/c

KËPUCË VERE PËR SHËRBIMET E VEÇANTA



KOSTUMI CEREMONIAL PER TRUPEN CEREMONIALE

